



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority



Në mbështetje të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 28, paragrafi 1.10 (Gazeta zyrtare nr. 88, e datës 25.11.2010) si dhe të Ligjit nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 5 dhe neni 7A, paragrafi 2, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, me datë 14.11.2019, nxjerr këtë:

RREGULLORE NR. 02/2019 PËR
KATEGORITË E MARRËVESHJEVE TË SPECIALIZIMIT

Neni 1
Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje janë të gjitha marrëveshjet që janë lidhur nga ndërmarrjet dhe që kanë të bëjnë me kushtet në të cilat ato specializohen për prodhimin e të mirave dhe/ose ofrimin e shërbimeve që duhet të jenë përfshirë në fushën e zbatimit të kësaj rregulloreje. Përfshirja do të zbatohet edhe për dispozitat e atyre marrëveshjeve të specializimit të cilat nuk kanë specializimin objektiv primar të tyre, por që janë të lidhura direkt me zbatimin, si dhe me probleme blerjeje, ose/dhe marketingu.
2. Në këtë rregullore përfshihen:
 - a) Marrëveshjet, ku njëra palë i jep plotësisht, apo pjesërisht të drejtën e prodhimit, ose ofrimit të produkteve, ose shërbimeve të caktuara në favor të një pale tjetër (i ashtuquajturit-specializim i njëanshëm);
 - b) Marrëveshjet, në të cilat çdo palë plotësisht apo pjesërisht i jep të drejtën e prodhimit, ose ofrimit të produkteve ose shërbimeve të caktuara në favor të një pale tjetër (i ashtuquajturit-specializim i ndërsjelltë); dhe
 - c) Marrëveshjet, në të cilat palët ndërmarrin nismën të prodhojnë, ose ofrojnë bashkërisht produkte, ose shërbime të caktuara (prodhim i përbashkët).

Neni 2

Natyra e marrëveshjeve

1. Marrëveshjet e Specializimit në prodhim, nëse palët kanë aftësi plotësuese, asete, ose veprimtari, kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit, ose shpërndarjen e produkteve. Këto palë në marrëveshje mund të përqendrohen në prodhimin e produkteve të caktuara duke vepruar kështu në mënyrë më eficiente për të ofruar produkte me kosto sa më të ulët. Duke synuar mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, marrëveshja, do të vlerësohet ndër të tjera, edhe duke pasur parasysh që konsumatorët të marrin një ndarje sa më të drejtë të përfitimeve ekonomike që rrjedhin prej saj.
2. Natyra e marrëveshjeve, të njëanshme ose/dhe të ndërsjella, kërkon që ato të jenë aktive në të njëjtin treg produkti, por nuk është e nevojshme të jenë aktive në të njëjtin treg gjeografik. Marrëveshjet e prodhimit të përbashkët mund të lidhen midis palëve, të cilat janë aktive në të njëjtin treg produkti, por gjithashtu edhe për ato palë, të cilat dëshirojnë të hyjnë në një treg produkti nëpërmjet një marrëveshjeje.

Neni 3

Përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - (a) ‘marrëveshje specializimi’ nënkupton një marrëveshje të njëanshme të specializimit, një marrëveshje reciproke të specializimit ose një marrëveshje të prodhimit të përbashkët;
 - (b) ‘marrëveshje e njëanshme e specializimit’ nënkupton një marrëveshje midis dy palëve që janë aktive në të njëjtin treg të produkteve, në bazë të së cilës njëra palë pranon të ndërpresë plotësisht ose pjesërisht prodhimin e produkteve të caktuara ose të përmbahet nga prodhimi i atyre produkteve dhe t’i blejë ato nga pala tjetër, e cila pajtohet të prodhojë dhe furnizojë ato produkte;
 - (c) ‘marrëveshje reciproke e specializimit’ nënkupton një marrëveshje midis dy ose më shumë palëve që janë aktive në të njëjtin treg të produkteve, në bazë të së cilës dy ose më shumë palë në mënyrë reciproke pajtohen që të ndalojnë plotësisht ose pjesërisht ose të përmbahen nga prodhimi i produkteve të caktuara, por të ndryshme dhe t’i blejnë këto produkte nga palët e tjera, të cilët pranojnë t’i prodhojnë dhe furnizojnë ato;
 - (d) ‘marrëveshje e prodhimit të përbashkët’ nënkupton një marrëveshje në bazë të së cilës dy ose më shumë palë pajtohen të prodhojnë produkte të caktuara bashkërisht;
 - (e) ‘marrëveshje’ marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, pra marrëveshje horizontale ose në nivele të ndryshme, pra marrëveshje vertikale, të tregut.

- (f) ‘produkt’ nënkupton një mall ose një shërbim, përfshirë të dyjat, edhe mallrat ose shërbimet e ndërmjetme edhe mallrat ose shërbimet përfundimtare, me përjashtim të shërbimeve të shpërndarjes dhe qirasë;
 - (g) ‘prodhim’ nënkupton prodhimin e mallrave ose përgatitjen e shërbimeve dhe përfshin prodhimin përmes nënkontraktim;
 - (h) ‘përgatitja e shërbimeve’ nënkupton veprimtaritë paraardhëse të ofrimit të shërbimeve për klientët;
 - (i) ‘tregu përkatës’ fusha e tregtisë për të cilën konkurrenca është kufizuar në një zonë të caktuar gjeografike, duke përfshirë të gjitha produktet dhe shërbimet e zëvendësueshme për të cilat konsumatorët mund të drejtohen në afat sa më të shkurtër, në rast se kufizimi apo abuzimi rezultojnë në ngritjen e çmimit;
 - (j) ‘produkt specializimi’ nënkupton një produkt i cili prodhohet në bazë të një marrëveshje specializimi;
 - (k) ‘produkt ardhës’ do të thotë një produkt për të cilin një produkt specializimi përdoret nga një ose më shumë nga palët si një input dhe i cili shitet nga ato palë në treg;
 - (l) ‘ndërmarrje konkurruese’ do të thotë një konkurrent aktual ose i mundshëm;
 - (m) ‘konkurrent aktual’ nënkupton një ndërmarrje që është aktive në të njëjtin treg përkatës;
 - (n) ‘konkurrent potencial’ nënkupton një ndërmarrje që, në mungesë të marrëveshjes së specializimit, do të bënte, mbi baza reale dhe jo thjesht si një mundësi të thjeshtë teorike, në rast të një rritje të vogël por të përhershme të çmimeve relative ka të ngjarë të ndërmarrë, brenda jo më shumë se 3 vjetësh, investimet e nevojshme shtesë ose kostot e tjera të nevojshme të ndërrimit për të hyrë në treg përkatës;
 - (o) ‘detyrim ekskluziv i furnizimit’ do të thotë një detyrim për të mos furnizuar një ndërmarrje konkurruese përveç një pale në marrëveshje me produktin e specializimit;
 - (p) ‘detyrim ekskluziv i blerjes’ nënkupton një detyrim për të blerë produktin e specializimit vetëm nga një palë në marrëveshje;
 - (q) ‘e përbashkët’, në kontekstin e shpërndarjes, do të thotë që palët:
 - (i) kryejnë shpërndarjen e produkteve me anë të një ekipi, organizate ose ndërmarrje të përbashkët; ose
 - (ii) emërojnë një shpërndarës të palës së tretë në një bazë ekskluzive ose jo-ekskluzive, me kusht që pala e tretë të mos jetë një ndërmarrje konkurruese;
 - (r) ‘shpërndarje’ nënkupton shpërndarje, përfshirë shitjen e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve.
2. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat ‘ndërmarrje’ dhe ‘palë’ përfshijnë ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura.

‘Ndërmarrje e lidhur’ nënkupton:

- (a) ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshjen e specializimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi:
 - (i) ka fuqinë të ushtrisë më shumë se gjysmën e të drejtave të votimit;
 - (ii) ka fuqinë të emërojë më shumë se gjysmën e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, bordit të menaxhimit ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen; ose
 - (iii) ka të drejtë të menaxhojë punët e ndërmarrjes;
- (b) ndërmarrjet të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë, mbi një palë në marrëveshjen e specializimit, të drejtat ose fuqitë e listuara në pikën (a);
- (c) ndërmarrjet në të cilat një ndërmarrje e përmendur në pikën (b) ka, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të drejtat ose fuqitë e listuara në pikën (a);
- (d) ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshjen e specializimit së bashku me një ose më shumë ndërmarrje të përmendura në pikat (a), (b) ose (c), ose në të cilat dy ose më shumë prej ndërmarrjeve të fundit, së bashku kanë të drejtat ose kompetencat e listuara në pikën (a);
- (e) ndërmarrjet në të cilat të drejtat ose fuqitë e listuara në pikën (a) mbahen bashkërisht nga:
 - (i) palët në marrëveshjen e specializimit ose ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura, në pikat (a) deri (d); ose
 - (ii) një ose më shumë nga palët në marrëveshjen e specializimit ose një ose më shumë prej ndërmarrjeve të tyre të lidhura të përmendura në pikat (a) deri (d) dhe një ose më shumë palë të treta.

Neni 4

Marrëveshjet e specializimit që përjashtohen nga ndalimi

1. Në përputhje me nenet 5 dhe 6 të Ligjit nr. L - 03/229, datë 07.10.2010 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 4 i ligjit nuk do të zbatohet për marrëveshjet e specializimit. Ky përjashtim nuk do të zbatohet për ato marrëveshje të specializimit, të cilat nuk përmbajnë kufizime të konkurrencës, ku këto të fundit janë objekt i nenit 4 të ligjit.
2. Përjashtimi i parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni do të zbatohet edhe për marrëveshjet e specializimit, që përmbajnë dispozita, të cilat lidhen me dhënien, ose licencimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të një ose më shumë palëve, duke siguruar që këto dispozita nuk përbëjnë objektin parësor të kësaj marrëveshjeje, por janë të nevojshme dhe drejtpërdrejtë të lidhura me zbatimin e tyre.
3. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, do të zbatohet për marrëveshjet e specializimit ku:
 - a) Palët bien dakord për një blerje ekskluzive ose detyrim ekskluziv për furnizim; ose,
 - b) Palët nuk shesin në mënyrë të pavarur produktet e specializimit por bashkërisht shpërndajnë këto produkte.

Neni 5

Pragu i pjesëmarrjes në treg

Përrjashtimi i parashikuar në nenin 4 aplikohet me kushtin që pjesëmarrja e kombinuar në treg e palëve të mos kalojë 20% në tregu përkatës.

Neni 6

Kufizimet e rënda

Përrjashtimi i parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje, nuk do të zbatohet për ato marrëveshje specializimi të cilat, direkt ose indirekt, veçmas ose së bashku me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë për objekt:

- a) Fiksimin e çmimeve për shitjen e mallrave tek të tretët, me përrjashtim të fiksimit të çmimeve të zbatuara tek klientët e drejtpërdrejtë në kuadër të shpërndarjes së përbashkët;
- b) Kufizimin e prodhimit, ose shitjes me përrjashtim të:
 - 1) Dispozitave mbi sasinë e produkteve në kuadër të marrëveshjeve të specializimit të njëanshme, ose reciproke, ose vendosjen e kapaciteteve dhe volumit të prodhimit në kuadër të një marrëveshjeje prodhimi të përbashkët, dhe
 - 2) Vendosjes së shitjeve të planifikuara në kuadër të shpërndarjes së përbashkët.
- c) Ndarjen e tregjeve ose klientëve/konsumatorëve.

Neni 7

Përrllogaritja dhe zbatimi i pragut të pjesës së tregut

Për qëllime të përrllogaritjes së Pragut të Pjesës së Tregut sipas neni 5 të kësaj rregulloreje, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

- 1) Pjesa e tregut përrllogaritet mbi bazën e vlerës së shitjeve në treg. Në mungesë të të dhënave lidhur me vlerën e shitjeve në treg, përcaktimi i pjesës së tregut të palëve, mund të gjendet mbi bazën e vlerësimeve të mbështetura mbi informacione të tjera të besueshme të cilat kanë të bëjnë me tregun dhe pikërisht vëllimin e shitjeve mbi këtë të fundit;
- 2) Pjesa e tregut përrllogaritet mbi bazën e të dhënave që lidhen me vitin paraprak kalendarik;
- 3) Nëse pjesa e tregut e referuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje është fillimisht jo më tepër se 20%, por në vijim rritet mbi këtë prag pa e kaluar 25%, përrjashtimi i ofruar në nenin 4 do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej 2 vitesh të njëpasnjëshme kalendarike, duke pasuar vitin në të cilin pragu prej 20% është tejkaluar për herë të parë;
- 4) Nëse pjesa e tregut e referuar në nenin 5 është fillimisht jo më tepër se 20%, por ndërkohë tejkalon mbi 25%, përrjashtimi i parashikuar në nenin 4 do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej 1 viti kalendarik që ndjek vitin në të cilin niveli prej 25% është tejkaluar për herë të parë.

5) Përfitimet sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni nuk mund të mblidhen për shkak se tejkalohet kohëzgjatja prej 2 vitesh kalendarike.

Neni 8

Dispozitat kalimtare

Në rast të vështirësive për aplikimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje apo mungesës së dispozitave për marrjen e vendimit përfundimtar, duhet të aplikohen dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 9

Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores

Ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

KOMISIONI

AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS

(_____)

Valon Prestreshi
Kryetar

(_____)

Ahmet Krasniqi
Zëvendëskryetar

(_____)

Fatime Haziri
Anëtare

(_____)

Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)

Shaqir Morina
Anëtar